



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE

Nr. 6819 Prot 29.12.2000



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

Nr. 1366 Prot 22.6.1999



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA E PERGJITHSHME

Nr. 41 Prot 24.01.2001.

UDHËZIM

RREGULLA TE DETYRUESHME MBI KËQYRJEN E VENDIT TE NGJARJES. KRYERJES SE AUTOPSISË, EKZAMINIMEVE E ANALIZAVE

Me qellim qe, te forcohet puna ne drejtim te zbatimit te rregullave procedurale e ligjore, për këqyrjen e vendit te ngjarjes, kryerjen e autopsive, analizave, etj., ne rastet e ngjarjeve me viktima, apo kur lind e nevojshme kryerja e ekspertimeve mjeko-Ligjore, ne mbështetje te nenit 102, pika 4, te Kushtetutës se Republikës se Shqipërisë dhe te neneve 6, 7 e 13 te ligjit Nr. 7830, date 15.06.1994 "Për Autopsitë",

UDHËZ O J M Ë :

1. Ne rastet e ngjarjeve me viktima, te vdekjeve me dhune te llojeve te ndryshme si: vrasje, vetëvrasje, aksident, lezione mekanike, helmime, asfiksi mekanike, veprimi i temperaturave ekstreme, korent elektrik etj; vdekjeve te papritura jashtë ose brenda institucioneve shëndetësore, kur nuk dihet me saktësi shkaku i vdekjes; ne vdekjet e fëmijëve te porsalindur, qe kane lindur jashtë institucioneve shëndetësore;

ne vdekjet e personave te panjohur ose ne rastet e kufomave te copëzuar ose te kalbëzuara, etj., është e nevojshme kryerja e detyrueshme e autopsisë.

2. Për rastet e theksuara me lart, organet e prokurorisë, te policisë gjyqësore dhe te ruajtjes se rendit janë te detyruara, te marrin te gjitha masat për ruajtjen e vendit te ngjarjes, fiksimin e gjurmëve dhe provave materiale, sigurimin e transportit te kufomës ne morg ose ne vendin ku do te kryhet autopsia, sigurimin e personelit mjeko-ligjor gjate autopsisë dhe sigurimin e transportit te materialeve te marre për ekzaminime plotësuese ne laboratorët përkatës. Ne lidhje me kohen se kur do te kryhet autopsia, te tregohet kujdes ne drejtim te organizimit te punës ne mënyre qe, mundësisht, ky veprim te behet ne intervalin nga ora 8.00-16.00, kohe ne te cilën ndriçimi natyror është i mjaftueshëm.
3. Te tregohet kujdes dhe te bëhen te gjitha përpjekjet qe objekti i autopsisë te dërgohet ne morg, ku edhe kushtet janë maksimale. Vetëm ne raste te jashtëzakonshme dhe kur shkaqet e ngjarjes janë te qarta, te mjaftohet me kryerjen e ekspertimit ne vend dhe te lejohet marrja e kufomës nga familja, pa ju nënshtruar autopsisë,
4. Ne zbatim te nenit 179, pika 1 te K.Pr.P., vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-Ligjor te mos jete nominal, (ne emër te një eksperti konkret) por te dërgohet, gjithmonë, pranë Shërbimit Qendror te Ekspertimit Mjeko-Ligjor, ku pasi merret ne dorëzim sipas rregullave, jepet urdhri përkatës për kryerjen e punës, nga drejtuesi i institucionit. Vendimi për kryerjen e ekspertimit te jete ne dy kopje, te cilat pasi evidentohen dhe jepet urdhri përkatës për kryerjen e ekspertimit nga shefi i këtij shërbimi, protokollohen dhe një kopje qëndron ne sekretarinë e SHQELM-it, ndërsa kopja tjetër, bashke me aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, i kthehet organit i cili ka kërkuar ekspertimin. Ne rastet kur organi qe urdhëron kryerjen e ekspertimit, ka ndonjë preference apo rezerve, për ndonjë ekspert konkret, mundet t’jua beje prezent ketë, drejtuesit te SHQELM-it, ne shkresën përcjellëse te vendimit te ekspertimit.
5. Kur është e nevojshme kryerja e analizave toksikologjike, sidomos te drogës dhe te lendeve helmuese, me qellim qe te evitohen ndërhyrjet dhe deformimet e rezultatit te analizave, kur çmohet nga organi qe urdhëron kryerjen e ekspertimit, te aplikohet kryerja e analizës paralele, ne laboratorin e SHQELM dhe ne Laboratorin Qendror Kriminalistik.
6. Për kryerjen e ekzumimeve, te mbahet parasysh, kryerja e tyre, mundësisht, ne orët e para te mëngjesit, kur lëvizja e njerëzve është e kufizuar, me qellim qe te shmanget përshtypja qe krijohet ne raste te tilla ne ambientin rrethues. Organet e policisë, te

marrin te gjitha masat për krijimin e kushteve normale te punës, duke siguruar ruajtjen e vendit te kryerjes se ekzumimit, duke shoqëruar mjeket gjate ardhjes dhe gjate largimit nga ky vend e deri ne përfundim te veprimeve, analizave etj.

7. Organi i prokurorisë dhe hetimit, ne te gjitha rastet e vdekjeve te dhunshme, për te cilat ka filluar çështja penale dhe është kërkuar ekspertimi mjeko-ligjor, duhet te zbatojnë kërkesat e nenit 10 dhe 11 te ligjit Nr. 7830, date 15.06.1994 "Për Autopsitë" dhe te nenit 15 te ligjit Nr. 5840, date 20.02.1979 "Për Aktet e Gjendjes Civile" dhe te kujdesen për p3otesimin e skedës se vdekjes nga mjeku- ligjor. Pasi merret ky dokument, te jepet leja e varrimit dhe te dërgohet urdhri për te bere veprimet ne aktet e gjendjes civile, brenda tre ditëve nga data e ngjarjes.
8. Ky udhëzim hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISE


ARBEN IMAMI

MINISTRI I RENDIT PUBLIK


ILIR GJONI



MIRATOHET

PROKURORI I PERGJITHSHEM


ARBEN RAKIPI

